



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

*Kryetari*

Nr. 2994 prot.

Tiranë, më 24. 11. 2020

**URDHËR**

Nr. 62, datë 24.11.2020

**PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 26.11.2020, ORA 10.00**

Në mbështetje të nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin tre javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 9 - 27 nëntor 2020,

**URDHËROJ:**

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancën plenare të datës 26.11.2020, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
  1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 16.11.2020
  2. Njoftimi i çështjeve të depozituara në Kuvend për shqyrtim
  3. Interpelancë urgjente me Kryeministrin kërkuar nga deputeti Ralf Gjoni. Interpelancë urgjente me ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kërkuar nga grup deputetësh. *(Për shkak të objektivit të njëjtë, në mbështetje të nenit 89 të Rregullores, do të zhvillohet votim për bashkimin e interpelancave. Zhvillimi i tyre mbetet në varësi të vendimmarrjes së Kuvendit)*
  4. Akt normativ nr. 32, datë 12.10.2020 “Për një ndryshim në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar”.
  5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për projektin bashki të forta”.
  6. Projektligji “Për censin e popullsisë dhe të banesave”.
  7. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.
  8. Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 11812, datë 5.11.2020, “Për kthimin e ligjit nr. 130/2020, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”.
  9. Projektvendim “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve me kohë jo të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.
  10. Projektvendim “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”.
  11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për marrjen e masave mbrojtëse të nevojshme për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në seancë plenare.

IV. Ngarkohen Shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

V. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

**Gramoz RUÇI**





# SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 26 nëntor 2020, ora 10.00

## RENDI I DITËS

Në mbështetje të Urdhrit nr. 62, datë 24.11.2020 të Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 16.11.2020  
(Neni 44, pika 2 e Rregullores)
2. Njoftimi i çështjeve të depozituara në Kuvend për shqyrtim  
(Neni 44, pika 3 e Rregullores)
3. **Interpelancë me Kryeministrin kërkuar nga deputeti Ralf Gjoni. Interpelancë urgjente me ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kërkuar nga grup deputetësh.** (Për shkak të objektit të njëjtë, në mbështetje të nenit 89 të Rregullores, do të zhvillohet votim për bashkimin e interpelancave. Zhvillimi i tyre mbetet në varësi të vendimmarrjes së Kuvendit). (Neni 80 Kushtetutë, neni 96, 97 Rregullore)
4. **Akt normativ nr. 32, datë 12.10.2020 “Për një ndryshim në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar”.** (Neni 101 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)  
Pyetje  
Shprehet nismëtari  
Relatore: Klotilda Bushka  
Shprehet komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Dhënie mendimi komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë  
Diskutime  
(Shprehen grupet parlamentare)  
Koha e votimit
5. **Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për projektin bashki të forta”.** (Neni 121 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)  
Pyetje  
Shprehet nismëtari  
Relator: Adnor Shameti  
Shprehet komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Dhënie mendimi komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin  
Dhënie mendimi komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik  
Dhënie mendimi komisioni për Politikën e Jashtme  
Diskutime  
(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit në parim, nen/nen, në tërësi

6. [Projektligj “Për censin e popullsisë dhe të banesave”](#). (Neni 78 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)  
Pyetje  
Shprehet nismëtari  
Relatore: Milva Ekonomi  
Shprehet komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat  
Dhënie mendimi komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin  
Dhënie mendimi komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik  
Dhënie mendimi komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë  
Dhënie mendimi komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Dhënie mendimi komisioni për Integrimin European  
Diskutime  
(Shprehen grupet parlamentare)  
Koha e votimit në parim, nen/nen, në tërësi
7. [Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014 “Për Urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”](#)”. (Neni 78 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)  
Pyetje  
Shprehet nismëtari  
Relatore: Ardiana Jaku  
Shprehet komisioni përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë  
Diskutime  
(Shprehen grupet parlamentare)  
Koha e votimit në parim, nen/nen, në tërësi
8. [Dekret i Presidentit të Republikës nr. 11.812, datë 5.11.2020 “Për kthimin e ligjit nr. 130/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10129 datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”](#)”. (Neni 85 i Kushtetutës dhe nenet 86 dhe 73-77 të Rregullores. Dekreti humbet fuqinë e tij kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit)  
Relatore: Vasilika Hysi  
Shprehet komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Diskutime  
(Shprehen grupet parlamentare.)  
Koha e votimit
9. [Projektvendim “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve me kohë jo të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”](#).  
(Neni 78 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, ligji nr. 10.019/2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar””, shumicë e thjeshtë votash për miratim)  
Relator: Bashkim Fino  
Shprehet komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Diskutime  
(Shprehen grupet parlamentare)  
Koha e votimit
10. [Projektvendim “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”](#). (Nenet 78 dhe 83 të Kushtetutës dhe nenet 28 dhe 55 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)  
Shprehet një folës pro dhe një folës kundër  
Koha e votimit
11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).